Ndërmarrje publike lokale | Rr. Egnatia . - 10 000 Prishtinë |www.kuzhina.net| kuzhinaqendrore@gmail.com | tel: 038548222

RAPORT I PUNËS

(31 Mars -30 Qershor 2022)

Prishtinë, Qershor 2022

Përmbajtja

Lista e shkurtesave ... 3
Përmbledhje ekzekutive ... 4
Për ndërmarrjen ... 6
Vizioni i Kompanisë ... 6
Misioni i Kompanisë ... 6
Qëllimet ... 6
Objektivat e ndërmarrjes ... 7
Korniza Ligjore ... 7
Komisioni Komunal i Aksionarëve ... 7
Bordi i drejtorëve ... 8
Zyra e Kryeshefit ... 8
Memorandume bashkëpunimi dhe marrëveshje për shërbime ... 8
Takime pune ... 8
Informimi dhe avokimi ... 10
Zyra e Prokurimit ... 10
Tab. 1. Aktivitetet e Zyrës së Prokurimit ... 11
Departamenti i Administratës ... 12
Departamenti i Prodhimit ... 13
Tab. 2 Përgatitja e shujtave Mars – Qershor 2022 ... 14
Departamenti i Financave ... 14
Tab. nr. 3 Pasqyra e të ardhurave gjithëpërfshirëse ... 14
Tab. 4 Shpenzimet për paga dhe kompensime të tjera ... 17
Tab. 5 Pagesa për anëtarët Bordit të Drejtorëve dhe Komisionin Komunal të Aksionarëve ... 17
Tab. 6 Shpenzimet për mbushje telefonike dhe Shpenzimet e mbledhjeve. ... 17
Tab. 7 Shpenzimet e reprezentacionit ... 18
Obligimet Tatimore ... 18
Tab. 8 Llogaritja e tatimit në fitim ... 18
Tab. 8 Pagesa e Tatimit mbi Vlerën e Shtuar (TVSH) ... 18
Ngritja e kapaciteteve të ndërmarrjes ... 18
Anex 1 Lista e Institucioneve parashkollore ... 19

Lista e shkurtesave

NPL – Ndërmarrje publike lokale

KQ- Kuzhina Qendrore

KK – Kuvendi Komunal

KP- Komuna e Prishtinës

KA – Komisioni i Aksionarëve

KB - Kryesuesi i Bordit

DB – Drejtorët e Bordit

KAB – Komisioni i Auditimit të Brendshëm

KE – Kryeshefi Ekzekutiv

QKMF - Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare

IP - Institucionet Parashkollore.

Përmbledhje ekzekutive

Bazuar në Ligjin nr. 03/L-087 për ndërmarrjet publike, neni 31 paragrafi 31.1, brenda 30 ditëve pas përfundimit të çdo tremujori kalendarik, zyrtarët e NP-së do të përgatisin dhe dorëzojnë në Bordin e Drejtorëve një raport për tremujorin e sapo përfunduar.

Sipas Ligjit Raporti tremujore, duhet të përmbaj një pasqyrë të strukturës organizative të NP, duke përfshirë të gjitha ndryshimet e konsiderueshme që janë bërë gjatë tremujorit përkatës; një shqyrtim të përformancës afariste dhe financiare gjatë tremujorit përkatës; një përmbledhje të të gjitha procedurave gjyqësore ose të arbitrazhit të pambaruar ose të kërcënuara, ose që mund të përfshijnë NP-në; një përshkrim të procedurave gjyqësore ose të arbitrazhit të cila NP pritet t'i iniciojë gjatë tremujorit aktual; transaksionet e konsiderueshme që përfshijnë NP ose njësitë e saj ndihmëse; dhe sugjerime dhe propozime për ndryshime të cila me arsye pritet që ta rrisin përformancën e NP-së.

Raporti i NPL Kuzhina Qendrore sh.a. për periudhën raportues në vete përmban informata të thukëta sa i përket ndërmarrjes. Raporti flet për misionin dhe vizionin e saj si dhe paraqet objektivat zhvillimore për periudhën në vijim.

Në një pjesë, raporti flet për angazhimet, detyra dhe përgjegjësit e Bordit të Drejtorëve, dhe pasqyron angazhimin e tyre në drejtim të konsolidimit dhe forcimit të ndërmarrjes.

Raporti nuk le pa përmendur edhe zhvillimet e brendshme në ndërmarrje, veçmas tek respektimi i marrëveshjeve që ka me Komunën e Prishtinës për përgatitjen, dërgimin dhe shërbimin e shujtave për Institucionet parashkollore dhe për familjet më gjendje të rend sociale.

Raporti përfshinë punën e të gjitha departamenteve të ndërmarrjes dhe aty paraqiten të gjitha veprimet që janë bërë. Jepet një pasqyrë e aktiviteteve që kanë ndodhur në administratën e ndërmarrjes. Pasqyrohet të dhëna rreth kontakteve të përditshme më partnerët tanë, siç janë Institucionet Parashkollorë Publike dhe ato më bazë në komunitet.

Raporti shpërfaqe edhe lëvizjet financiare që janë bërë në ndërmarrje nga 31 Marsi deri më 30 Qershor 2022. Aty shihet që ndërmarrja ka pasur në vazhdimësi një trend rritës dhe ka pasur tendencë të dërgimit të shujtave sipas porosive edhe tek operatorët e tjerë, pra jo vetëm tek sektori publike.

Ngjashëm si në TM1, kjo periudhe përshkruhet më një aktivitet të shtuar të Zyrës së Prokurimit, e cila ka shpallur dhe përfunduar disa procedura tenderuese, të cilat kanë pasur një ndikim të jashtëzakonshëm në mbarëvajtjen e punëve në ndërmarrje.

Kontakti me institucionet e tjera publike si dhe më ndërmarrjet partnere, qofshin të nivelit lokal apo qendrore, nuk ka munguar, dhe siç paraqitet në raport ka qenë mjaftë i dendur, duke filluar nga Administrata Tatimore e deri të ndërmarrjet publike qendrore dhe lokal.

Sa i përket buxhetit të ndërmarrjes, raporti tregon se ky tremujor ka një trend pozitiv të të hyrave, çka i kanë siguruar ndërmarrjes një stabilitet solid në kryerjen e të gjitha obligimeve të mëhershme apo të krijuara gjatë kësaj periudhe.

Duke shpresuar që kemi arritur t'i përmbledhim të gjitha punët dhe angazhimet që janë bërë nga stafi i Ndërmarrjes Publike Lokal Kuzhina Qendrore sh.a., ju falënderojmë për bashkëpunimin e treguar gjatë gjithë kësaj kohe.

Faleminderit!

Për ndërmarrjen

Ndërmarrja Publike "Kuzhina Qendrore" sh.a. është themeluar me datën 5 Qershor 2019 nga Kuvendi Komunal i Prishtinës. Kuzhina Qendrore aktualisht furnizon gjithsej 16 çerdhe, prej të cilave 8 janë publike dhe 8 me bazë në komunitet

Struktura organizative e ndërmarrjes është e ndërtuar bazuar në përgjegjësit ligjore që rrjedhin nga Ligji nr. 03/L-087 për ndërmarrjet publike. Ndërmarrja udhëhiqet sipas kësaj hierarkie: Komisioni Komuna i Aksionare, që emërohet nga Kuvendi Komunal dhe Kryetari i Komunës, Bordi i Drejtorëve që emërohen përmes një procesi rekrutues nga Komisioni Komunal i Aksionarëve si dhe Kryeshefi Ekzekutiv i ndërmarrjes që përmes një procesi rekrutues emërohet nga Bordi i Drejtorëve të ndërmarrjes. Kjo është struktura e nivelit të lartë që menaxhon me ndërmarrjen.

Kuzhina Qendrore aktualisht furnizon gjithsej 16 çerdhe, prej të cilave 8 janë publike dhe 8 me bazë në komunitet (Lista në Anex 1). Bazuar në kapacitetet aktuale, ndërmarrja mundet në çdo kohë të rris kapacitetin e shujtave për këtë kategori të shoqërisë nëse diçka e tillë kërkohet.

Aktualisht, ndërmarrja përgatitë 3 shujta në ditë për afërsisht 2490 fëmijë prej të cilëve 1651 të çerdheve publike dhe 839 fëmijë nga çerdhet me bazë në komunitet si dhe 500 shujta ne dite për 2 Qendrat Sociale (Aktash dhe Tophane). Gjatë vitit të parë të projeksioneve, numri i fëmijëve në çerdhe publike do qëndroj i njëjtë përgjatë periudhës 2021-2022.

Vizioni i Kompanisë

N.P.L "Kuzhina Qendrore", sh.a. ka vizion të bëhet sinonim i ushqimit te shëndetshëm në Komunën e Prishtinës, dhe të njihet si shembull i përsosmërisë në ofrimin e produkteve ushqimore për fëmijët, bizneset dhe qytetaret e saj, si dhe duke aplikuar praktika më të mira Evropiane.

Misioni i Kompanisë

Misioni ynë është të vazhdojmë angazhimin për ushqim të shëndetshëm, me cilësi, standarde të larta, shije të mirë dhe çmim të volitshëm.

Qëllimet

Kuzhina Qendrore ka për qellim që të jetë një ndërmarrje publike e suksesshme, e qëndrueshme financiarisht, me synim të zgjerimit të investimeve të reja kapitale në kapacitetet prodhuese e shërbyese në gastronomi, investimet kapitale në industritë ndërlidhëse prodhuese (ushqimore), të arrij kapacitetin maksimal prodhues në fushën e industrisë ushqimore dhe të bëhet faktor i rëndësishëm i zhvillimit ekonomik lokal.

Objektivat e ndërmarrjes

Ndërmarrja publike lokale "Kuzhina Qendrore" sh.a. brenda funksionimit të saj dhe brenda detyrave primare, që ia përcakton fushë veprimtari që ushtron por edhe aktet ligjore, ka analizuar dhe hartuar disa caqe afariste të cilat i ka shndërruar në objektiva dhe aktivitete:

- Shtimi i kapaciteteve të furnizimit të Institucioneve Parashkollore, pavarësisht natyrës, me ushqim të freskët, cilësor dhe të bollshëm;
- Shtimi i kapaciteteve prodhuese përmes investimeve të reja kapitale;
- Zgjerimi i bashkëpunimit me institucione publike dhe institucione tjera relevante për furnizime me shujta ditore;
- Zgjerimi i bashkëpunimit me bizneset private për furnizim të rregullt me shujta ditore.

Korniza Ligjore

Ndërmarrja Publike Lokal "Kuzhina Qendrore" sh.a., është themeluar bazuar në Ligjin nr. 03/L-87 për ndërmarrjet publike. Është themeluar nga Kuvendi Komunal i Prishtinës, ku Komuna e Prishtinës është aksionar i 100%. Ndërmarrja fushë veprimtarinë e vet e bazon ne Ligjin për Ndërmarrjet Publike dhe Ligjin për Shoqëritë Tregtare, si dhe në aktet e brendshme të nxjerra nga Aksionarët dhe Bordi.

Gjatë tremujorit të dytë të këtij viti, ndërmarrja ka arritur që ti plotësoj dhe ndryshoj disa rregullore, që janë të domosdoshme për funksionalitetit e punëve në ndërmarrje.

Rregulloret janë përpiluar në bashkëpunim dhe me ndihmën e drejtorëve të Bordit Drejtues të cilat kanë dhënë mundin e tyre për të përfunduar këto dokumente bazike për funksionimin institucional të ndërmarrjes.

Komisioni Komunal i Aksionarëve

Kuvendi Komunal i Prishtinës, ka bërë konstituimin e Komisionit Komunal të Aksionarëve. Komisioni Komunal i Aksionareve, nga konstituimi ka mbajtur dy takime, në të cilat është hartuar dhe miratuar Statuti i Ndërmarrjes dhe Akti i Themelimit. Komisioni Komunal i Aksionarëve që nga kompletimi i zgjedhjes së tij ka asistuar dhe ka ndihmuar Bordin e Drejtorëve dhe menaxhmentin në sfidat dhe obligimet e ndërmarrjes e në veçanti në ndërlidhshmërin e obligimeve ndër institucionale të ndërmarrjes me Komunën e Prishtinës. Komisioni ka shprehur gatishmërinë të ndihmoj ndërmarrjen tonë drejtë përparimit të këtij institucioni në nivelet sa më të mira të mundshme

Bordi i drejtorëve

Bazuar në Ligjin nr. 03/L-87 për ndërmarrjet publike, Bordi i drejtorëve të Ndërmarrjes Publike Lokale "Kuzhina Qendrore sh. a., është në përbërje prej katër (4) drejtorëve që zgjidhen në një mbledhje të aksionarëve në përputhje me Ligjin për Shoqëritë Tregtare dhe secili ka mandat prej tri (3) viteve, ndërkohë anëtari i 5 i Bordit është Kryeshefi Ekzekutiv, i cili emërohet nga Bordi përmes procesi rekrutues. Sipas Ligjit për Ndërmarrjet Publike dhe sipas Ligjit për Shoqëritë Tregtare, Drejtorët e Bordit për punën dhe përgjegjësit e tyre i raportojnë Komisioni të Aksionarëve.

Gjatë periudhës raportuese Bordi i Drejtorëve të NPL Kuzhina Qendrore sh.a. ka mbajtur 4 mbledhje, ku janë shqyrtuar dokumente dhe procese me rendësi për ndërmarrjen.

Gjatë aktivitetit të tij, Bordi i Drejtorëve përveç rolit ligjor ka asistuar menaxhmentin e ndërmarrjes edhe në çështje të tjera organizative brenda ndërmarrjes duke u bërë kështu pjesë e pandashme e punës ekipore të ndërmarrjes.

Zyra e Kryeshefit

Në kuadër të Zyrës së Kryeshefit, sipas Rregullores për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës, përfshihen Zyra për Marrëdhënie me Publikun, Zyra Ligjore, Zyra e Prokurimit dhe Zyra e Auditimit.

Memorandume bashkëpunimi dhe marrëveshje për shërbime

Ndërmarrja në periudhën raportuese ka qenë e fokusuar në krijimin e kushteve për operimin në tregun jashtë Marrëveshjes në Shtëpi që e ka më Komunën e Prishtinës, e cila siguron dërgimin e shujtave të ngrohta për 16 Institucione Parashkollore dhe 500 shujta për rastet në gjendje të rëndë sociale.

Synimi ynë është që të rrisim prezencën tonë në tregun privat, duke u siguruar për shërbime dhe ushqim cilësor.

Takime pune

Në kuadër të detyrave dhe përgjegjësive gjatë periudhës raportuese janë organizuar një serë takimesh me palët e interesit por edhe me stafin e ndërmarrjes. Takimet me stafin e ndërmarrjes kanë qenë të rregullta javore.

Është zhvilluar takim me Drejtorinë e Mirëqenies Sociale, ku është synuar të behet riorganizimi dhe përmirësimi i kushteve të shpërndarjes se shujtave për rastet me gjendje të rend sociale. Ndërkohë, Komuna ka përfunduar procedurat për pajisjen me pjata të aluminit, ndërmarrja është në pritje dhe e gatshme në fillimin e procesit të paketimit dhe shpërndarjes se shujtave sipas dakordimit të mëhershëm

Siç e kemi paraqitur edhe në raportin e TM1, ndërmarrja ka insistuar në propozimin e saj që shpërndarja e shujtave të decentralizohet edhe në 3 ose 4 pika të tjera, veçmas në zonat me të thella rurale të Prishtinës, për t'iu mundësuar qytetarëve në nevojë, furnizim me të lehtë më shujta. Komuna ndonëse parimisht e përkrahë deri me tash nuk ka ndërmarr ndonjë iniciativë.

Takimi më kërkesë të Bashkësisë Islame. Ku është dakorduar që të nisin përgatitjen për fillimin e shpërndarjes se shujtave për nevoja të këtij institucioni. Po ashtu është dakorduar dhënia e kohë pas kohshme të produktit të mishit si donacion për ndërmarrjen.

Ndërmarrja ka qenë përfituese edhe i një donacioni tjetër nga organizata Humanity first. Ky donacion ka të bëjë me dhënien e 200 kg mish, qëllimi i të cili ka qenë të shpërndahet si shujtë e gatshme për familjet më gjendje të rend sociale.

Ndërmarrja ka negociuar dhe parimisht është pajtuar për nënshkrimin e një marrëveshjeje bashkëpunimi më Ndërmarrjen Publike Banesore, fryt i të cilës do të ishte intervenimet në mirëmbajtje të objekteve të NPL Kuzhina Qendrore.

Si rezultat i bashkëpunimit të mirë me Drejtorin për Investime Kapitale dhe Menaxhim të Kontratave të Komunës së Prishtinës, ndërmarrja ka arritur të siguroj intervenimin në përmirësimin e infrastrukturës rreth objektit të ndërmarrjes si dhe përmirësimit të rrjetit të ujëmbledhësit rreth objektit.

Është plotësuar dhe ndryshuar kontrata ne shtëpi me Komunën e Prishtinë, çka i ka hapur rrugë pagesës së faturave nga ana e Komunës ndaj ndërmarrjes.

Në këtë periudhe raportuar është përgatitur plani detal për hapjen e restorantit të ndërmarrjes, i cili parashihet të hapet në hapësirën afër ndërmarrjen.

Ndërkohë që suksesshëm është arritur të iniciohet dhe të përfundoj plani detal për instalimin e sistemit solar në kulmin e ndërmarrjes. Këtu përveç planit financiar, është bërë edhe plani i ndikimit në ambient, plani i kthimit të investimeve si dhe para masa e tërësishme e planit.

Bashkë më Bordin e Drejtorëve është punuar shumë në krijimin dhe plotësimin e akteve nën ligjore të ndërmarrjes dhe në këtë drejtim në periudhën raportuese janë aprovuar këto:

- Statuti i ndërmarrjes,
- Akti themeltar i ndërmarrjes,
- Rregulloren për marrëdhënie në punë
- Rregulloren për përgjegjësin disiplinore dhe materiale,
- Rregullore mbi Pagat dhe Kompensimet e tjera

- Rregullore për mirësjellje dhe Etike,
- Rregullore për trajnimin e stafit.
- Vendimi për themelimin e Komisionit për menaxhimin e procesit të rekrutimit;
- Vendimi për shpalljen e rekrutimit për nevoja të ndërmarrjes;
- Vendimi për komisionin ad-hoc për evidentimit e pajisjeve në magazinën e Kuzhinës,
- Vendimi për zbatimin e procedurave të pushimit ditor,
- Vendimi për krijimin e Komisionit të menysë për Institucionet Parashkollore,
- Vendimi për përgatitjen dhe publikimin e menysë për sektorin privat (shitjet ditore)
- Kërkesë për caktimin e kufijve kadastral të pronës së NPL Kuzhina Qendrore, drejtuar Komunës së Prishtinës;
- Kërkesë për zhvendosjen dhe lejen për vendosjen e laurës në oborrin e ndërmarrjes;
- Kërkesë për leje të zhvendosjes se gjeneratorit
- Vendimi për krijimin e dosjes së gjithsecilit të punësuar në ndërmarrje;
- Kërkesë për validitetin e librezave sanitare të stafit

Informimi dhe avokimi

Ndërmarrje në periudhën raportuese ka rritur prezencën e saj në mediat duke pasqyruar kështu gjithë punën që po bëhet nga stafi në tërësi për forcimin e ndërmarrjes por edhe të shërbimit.

Në periudhën raportuese është bërë tërësisht aktive dhe është plotësuar me informata ueb faqja e ndërmarrjes si dhe në baza ditore është freskuar me të dhëna faqja zyrtare në ndërmarrjes në Facebook.

Tendenca e jonë është që të forcojmë këtë sektor dhe njëkohësisht ta lehtësojmë qasjen deri tek informata.

Zyra e Prokurimit

Ndërmarrja ka iniciuar procedura prokurimi për përmbushjen e nevojave afariste. Me bartjen e administratës në objektin e kuzhinës ka qenë e nevojshme investimi në hapësirat punuese si: Montim dhe furnizim me dyer dhe dritare; Instalim i kamerave dhe sistemit për hyrje dalje. Të gjitha këto projekte tashme janë realizuar dhe janë në proces të pagesës së faturave, varësisht kohës kur operatori dorëzon faturën.

Proceset e tjera të prokurimit të cilat janë realizuar janë: Furnizimi me pajisje teknologjikë; Blerja e programit të kontabilitetit, Dizajnimi, krijimi dhe mirëmbajtja e ueb faqes së ndërmarrjes, furnizim me materiale higjienikë, furnizim me pemë e perime, instalim i laurës

automatike, furnizim dhe montim i veshjeve te mureve për zyre, furnizim dhe mirëmbajta e ndriçimit publik.

Tab. 1. Aktivitetet e Zyrës së Prokurimit

Procedurat e prokurimit	Shuma (€)	Statusi
Furnizim dhe instalim i kamerave	968.65	E përfunduar
Furnizim dhe instalim i sistemit të menaxhimit të hyrje-daljeve	350.00	E përfunduar
Furnizim dhe montim i dyerve	3,558.60	E përfunduar
Furnizim me pajisje të teknologjisë informative (PC)	1,660.00	E përfunduar
Furnizim me program të kontabilitetit	944.00	E përfunduar
Krijim, dizajnimi dhe mirëmbajtje e ueb faqes	977.00	E përfunduar
Furnizim me materiale higjienikë	14,166.40	E përfunduar
Furnizim me pemë dhe perime	67,482.42	E përfunduar
Instalimi i laurës automatike	1,530.00	E përfunduar
Furnizimi dhe montimi i veshjeve te mureve per zyre	4,400.00	E përfunduar
Furnizimi dhe mirëmbajtja e ndriçimit publik	595.00	E përfunduar

Projektet e përfunduara që nuk kanë pjesë e Planit të Biznesit për vitin 2022

- Furnizim dhe mirëmbajte ndriçimit publik ne vlere prej 595 eurove.
- Furnizimi dhe montimi i veshjeve te mureve ne vlere prej 4400 eurove.
- Instalimi i laurës automatike ne vlere prej 1530 eurove.
- Krijimi dizajnimi dhe mirëmbajte e ueb faqes ne vlere prej 977 eurove.

Departamenti i Administratës

N.P.L "Kuzhina Qendrore" sh.a. ka zhvilluar procedurë rekrutimi për staf esencial të ndërmarrjes.

Kjo procedurë rekrutimi është zhvilluar në ambientet e ndërmarrjes "Kuzhina Qendrore" nga data 8 Prill 2022 deri më 4 Maj 2022 duke ndjekur të gjitha procedurat dhe afatet ligjore, nga ku në fund të procesit në bazë të vlerësimit të Komisionit përzgjedhës janë rekrutuar 12 punonjës.

Në përputhje me nevojat dhe obligimet e ndërmarrjes si dhe për të përmirësuar edhe më tutje shërbimet tona, N.P.L "Kuzhina Qendrore" sh.a. ka punuar në pasurimin e menysë të cilën ua shërben fëmijëve.

Ndërmarrja ka zhvilluar disa projekte infrastrukturore të cilat rregullojnë si pamjen e jashtme po ashtu edhe hapësirën e brendshme të ndërmarrjes. Me këtë rast janë rregulluar zyrat e administratës së ndërmarrjes, është përmirësuar klima dhe ngrohja, kurse në ambientet e jashtme është investuar në digjitalizimin e rampës si dhe janë në përmirësim e sipër oborri dhe pusetet, të cilat do të shtohen me qëllim të përmirësimit të rrjetit të kanalizimit që lidhë ndërmarrjen tonë.

Gjatë kësaj kohe ndërmarrja jonë përmes një komisioni të brendshëm ka bërë evidentimin inventarit i cili gjendet në stoqet e ndërmarrjes tonë. Në këtë rast komisioni pritet të nxjerr rekomandimet e tij për inventarin i cili është në ndërmarrje.

Në sektorin e menaxhimit dhe zhvillimit të projekteve ndërmarrja, në kuadër të thirrjes publike të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë për ndërmarrjet në Kosovë, në programin "Intership Biznesi – 2022" ka aplikuar në këtë projekt për angazhimin e dy praktikantëve në fushën e teknologjisë ushqimore, praktikë kjo e cila do të zgjatë 3 muaj.

Në kuadër të sektorit të Logjistikës në këtë periudhë kohore, stafi i këtij sektori ka vazhduar në koordinim direkt me Departamentin e Prodhimit, të dërgon ushqimin në kopshte publike dhe në dy qendrat sociale në bazë të terrenit të përcaktuar.

Menyja ditore e kopshteve nga NPL" Kuzhina Qendrore "sh.a

Është pare e arsyeshme që menyja paraprake të ndryshohet për arsye se:
Ka pasur kohë të gjatë që nuk është ndryshuar, dhe duke qenë e përsëritshme çdo jave, rritë mundësinë që fëmijëve t'u krijohet monotoni.

Ka pasur mungesë të llojllojshmërisë së produkteve brenda javës, një nga pikat kyçe të një mënyre të shëndetshme të të ushqyerit.
Ka pasur ushqime me sasi të lartë të sheqerit të shtuar dhe sasi të kripës mbi dozën e rekomanduar.
Ka pasur zemrën e cila konsiderohet e pamjaftueshme, duke marrë parasysh se fëmijët e konsumojnë shujtën kryesore rreth orës 12:00, ndërkaq mbesin në kopsht deri ne orën 16:00.
Në menynë e re kemi pasur për qëllim:
Të krijojmë meny 4 – javore, si dhe të ndryshojmë frutat dhe perimet në bazë të stinës (pranverë – vërë dhe vjeshte dimër).
Të pasurojmë menynë me produkte të reja ushqimore, përfshire llojllojshmëri të drithërave, frutave dhe perimeve dhe të shtojmë peshkun një herë brenda katër javësh.
Të zëvendësojmë ushqimet me sasi të lartë të sheqerit të shtuar, me alternativa më të shëndetshme si dhe të krijojmë normativë të re për sasinë e kripës për fëmije.
Të rrisim sasinë dhe të kombinojmë dy apo tri ushqime gjatë mes vaktit, në mënyre që t'i mbajë fëmijët më të ngopur.

Departamenti i Prodhimit

Departamenti i Prodhimit, përfshin në vete pjesën e përgatitjes së ushqimit. Departamenti në vete ka 10 kuzhinier në angazhim.

Gjatë periudhës raportues, Departamenti ka arritur të përgatisë 173080 shujta për Institucionet Parashkollore dhe Qendrat Sociale, si dhe 521 shujta për sektorin privat.

Gjatë periudhës raportuese departamenti ka qenë i fokusuar në rritjen e cilësisë dhe sigurisë së ushqimit.

Departamenti ka vazhduar të kryej punët e Departamentit të Furnizimit dhe Distribuimit, meqë ky departament është në themelim e sipër.

Është bërë përgatitja e rregullt mujore e specifikacioneve të shujtave të cilat dërgohen në baza të përditshme në institucionet e IP, si dhe përgatitjen e konstatimeve të furnizimit nga operatorët ekonomik. Është bërë përgatitja mujore e specifikacionit dhe konstatimit për përgatitjen e faturës që i dërgohet Komunës, sipas Kontratës në shtëpi, të nënshkruar më Komunën e Prishtinës.

Është kujdesur dhe ka mbajtur kontakte të rregullta me Departamentin e Arsimit për ekzekutimin e pagesës se faturave si dhe në të njëjtën kohë ka mbajte kontakt më të gjitha Institucionet Parashkollore për tu kujdesur për mbarëvajtjen e procesit të përgatitjes dhe shpërndarjes se ushqimit.

Tab. 2 Përgatitja e shujtave Mars – Qershor 2022

Numri i shujtave		
Muaji	IP dhe Qendrat Sociale	Operatoret privat
Prill	56781	162
Maj	50774	160
Qershor	65525	199
Total	173080	521

Departamenti i Financave

Departamenti i financave për periudhën raportuese ka menaxhuar me gjithë procesin e financave, duke përfshirë edhe përgatitjen e listës së pagave dhe ekzekutimin e saj. Krahas punëve të tjera Departamenti i Financave ka qenë i angazhuar edhe në punë që janë në fushë veprimtari të departamenteve ose zyrave të tjera, siç është Zyra për Burimet Njerëzore dhe Departamenti për Furnizim dhe Distribuim.

Departamenti ka arritur që me sukses t'i përfundoj të gjitha procedurat, me përkrahjen e Zyrës së Prokurimit.

Për përudhen raportuese N.P.L Kuzhina Qendrore, sh.a. ka arritur të i kryej të gjitha obligimet ndaj punëtorëve siç janë pagat dhe transferet e tjera të parapara me normat ligjore.

Buxheti ka lëvizur nga muaji në muaj për shkak të lëvizjes se numrit të punëtorëve.

Tab. nr. 3 Pasqyra e të ardhurave gjithëpërfshirëse

Pasqyra e të Ardhurave Gjithëpërfshirëse		
		2022-6 muaj
4000	Te hyrat te cilat faturohen	469,753.50
	Të hyrat (te cilat transferohen ne llogari)	**279,733.19**
5000	**Kosto e shitjes**-Furnizime	201,270.08
Fitimi/ (humbja) bruto		**275,215.30**
4100	Të Ardhurat Tjera	**0.00**
5100	Shpenzimet e derivateve	2,414.23
5200	Shpenzimet administrative	18,802.7
5300	Shpenzimet e pagave	167,002.23

Totali i shpenzimeve operative			**188,219.16**
Fitimi/(humbja) operative			**86,996.14**
4200	Të ardhurat financiare		0.00
5500	Shpenzimet financiare		126.30
	Totali nga aktivitetet financiare		**-126.30**
	Te hyra nga aktivitetet tjera jo operative		0.00
	Shpenzime nga aktivitetet tjera jo operative		**0.00**
	Totali nga aktivitetet tjera jo operative		**0.00**
Fitimi/(humbja) para tatimit			**86,869.84**
5500	Shpenzimet e tatimit në fitim		2,172.43
Fitimi/ (humbja) i/e vitit			**84,697.41**

Te hyrat- Te hyrat përfshijnë numrin e shujtave shumëzuar me çmimin 1.50 euro për Qendrat Sociale dhe Institucionet Parashkollore. Kjo vlere i faturohet komunës çdo muaj. Totali i shumes se faturuar për gjashte muaj është 469,753.50 euro. Mirëpo sipas marrëveshjes ne shtëpi, Komuna e Prishtinës merr përsipër pagesën e furnizimeve deri ne maturimin e kontratave te prokurimit, andaj shuma e cila kompensohet NPL Kuzhina Qendrore është vlera e shitur minus vlera e furnizimeve. Shuma e cila është transferuar ne llogarinë bankare te Kuzhinës Qendrore është 279,733.21 euro për gjashte muaj. Këtu marrin pjese edhe shitjet ne sektorin privat – 635.59 euro, dhe disa fatura për departamente te ndryshme te komunës.

Kostoja e shitjes- Kmsh për këta gjashtë muaj arrin vlerën ne 201,270.08 euro. Kjo vlere është kompensuar nga Komuna e Prishtinës tek operatoret ekonomik. Me maturimin e një marrëveshje ndërmjet komunës dhe operatorit, ndërmarrja ka filluar nga gjysma e muajit qershor furnizimin me peme dhe perime. Vlera e shënuar për furnizim është 3828.72 euro. Andaj nga shuma e te hyrave minusohet kjo vlere e furnizimit dhe arrijmë ne fitimin bruto.

Fitimi/ humbja bruto- Paraqet vlerën e te hyrave minus vlerën e furnizimeve, qe ne ketë periudhe ndërmarrja ka shënuar fitim bruto 275,215.30 euro. Te ardhura tjera nuk ka.

Shpenzimet e derivateve- Pjese e shpenzimeve operative janë shpenzimet e derivateve. Gjate kësaj periudhe Kuzhina Qendrore ka arritur marrëveshje për furnizim me karburante nga operatori ekonomik. Kjo marrëveshje është realizuar nga muaji Mars.

Shpenzimet administrative- ky zë financiar përfshinë shpenzimet e bëra lidhur me komunalitë (rryme ujë) telefon internet mirëmbajte ,shpenzimet e reprezentacionit, shpenzimet e konkursit, shpenzimet e tenderit.

Shpenzimet e pagave- Totali i shpenzimeve për paga bruto se bashku me 5% -kontributin e punëdhënësit për ketë periudhe është 167,002.23 euro.

Shpenzimet Financiare- janë mbledhur shpenzimet e mirëmbajtjes dhe provizioneve bankare.

Shpenzimet e tatimit ne fitim- Paraqesin shpenzimet e bëra për dy periudhat e tatueshme TM1 dhe TM2.

Tabela për shpenzimet e pagave e ndare ne detaje për muaj është paraqitur në vijim. Me aprovimin e rregullores për paga është arritur një nivelim i pagave për pozita te ndryshme ne ndërmarrje, gjithashtu ka rezultuar me rritje të pagave për shumicën e punëtoreve në muajin qershor. Gjatë kësaj kohe është bere avancimi i një pjese te stafit ne pozita drejtuese te departamenteve ekzistuese te listuar ne organogram.

Tab. 4 Shpenzimet për paga dhe kompensime të tjera

	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor
Pagat bruto	22323.53	24989.8	28120.2	26962.97	26328.69	30230.03
Pagat neto	20289.3	22477.48	25323.27	24606.67	24086.94	27174.70
Tatimi në paga	1018.98	1181.98	1385.56	1374.61	1300.02	1607.81
Kontributet e punëtorit	1116.17	1249.29	2811.22	1348.14	1316.42	1512.06
Kontributet e punëdhënësit	1116.17	1249.29	2811.22	1348.14	1316.43	1512.06

Tabela në vijim tregon shpenzimet e bëra për periudhën raportues, për Drejtorët e Bordit të Drejtorëve, të cilat kategorizohen në honorarë. Shpenzimet kanë pasur trend rritës për shkak të përfshirjes së më vonshme të Komisionit Komunal të Aksionarëve në listën e pagave, deri ne muajin Prill. Totali i shpenzimeve arrin vlerën 12,140.12 euro.

Tab. 5 Pagesa për anëtarët Bordit të Drejtorëve dhe Komisionin Komunal të Aksionarëve

Bordi dhe Aksionaret	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Total
Honorari	1,160	2,420	2,464	2,032.044	2,032.04	2,032.04	12,140.12

Tab. 6 Shpenzimet për mbushje telefonike dhe Shpenzimet e mbledhjeve.

	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Totali
Shpenzime për tel	140	140	140	140	140	140	840
Shpenzime për mbledhje	7.2	78.8	0	100.7	0	87.2	273.9

Shpenzimet e reprezentacionit janë të rregulluara me Vendimin e Bordit të Drejtorëve të aprovuar në mbledhjen e dytë të bordit. Sipas këtij vendimi të drejtë në reprezentacion kanë pozitat e larta drejtuese të ndërmarrjes.

Kryeshefi Ekzekutiv gëzon një shumë të aprovuar për reprezentacion prej 200 euro në muaj. Shpenzimet e Kryeshefit Ekzekutiv të përmbledhura për gjashte muaj janë 236.44 euro, të cilat janë të mbështetura në fatura të rregullta. Totali i shpenzimeve për reprezentacion për tre muaj është 253.74 euro.

Tab. 7 Shpenzimet e reprezentacionit

Reprezentacion në €	Limiti i aprovuar	Të shpenzuara						
		Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Total
Kryeshefi ekzekutiv	200	0	92.51	84.83	56.1	0	0	236.44
Departamenti i Administratës	50	0	0	17.3	0	0	0	17.3

Obligimet Tatimore

Obligimet tatimore ndaj shtetit, janë paguar në tërësi. Pagesa e Tatimit në Fitim për tre mujorin e parë të vitit 2022 ishte 1542.80 kurse për tre mujorin e dyte është 629.63 euro. Ndërmarrja ketë periudhe te vitit ka paguar tatim mbi vlerën e shtuar rreth 46,331.84 euro ne total.

Tab. 8 Llogaritja e tatimit në fitim

	TM1	TM2
Të ardhurat e parapara për Periudhën Tatimore/4	36,545.51	33,388.65
Shpenzimet e parapara për Periudhën Tatimore/4	21,117.42	27,092.27
Fitimi i paraparë për Periudhën Tatimore /4	15,428.09	6,296.38
Kësti për TM (10%)	1,542.80	629.63

Tab. 8 Pagesa e Tatimit mbi Vlerën e Shtuar (TVSH)

TVSH	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Total
	8,278.86	10,376.85	6783.14	7,420.58	6,433.84	7,038.57	46,331.84

Ngritja e kapaciteteve të ndërmarrjes

Ndërmarrja ka trashëguar një staf, ku shumica prej tyre kanë përgatitje të mesme shkollore. Përveç kësaj stafi është në moshë të shtyrë. Në këtë pikë gjatë kësaj periudhe kohore ndërmarrja ka organizuar trajnimin e stafit të ndërmarrjes. Tematika e këtij trajnimi ka qenë gjuha e komunikimit, që nënkupton formën e prezantimit para tjetrit dhe ndërtimi i imazhit personal

Është bërë vlerësimi i kapaciteteve dhe nevojave të ndërmarrjes për investime në ngritjen e kapaciteteve, jo vetëm në personel por edhe në makineri. Ndërkohë gjatë kësaj periudhe janë nënshkruar kontratat e reja të punës, bazuar në rregullativen e re të ndërmarrjes.

Kemi angazhuar ekspert për të vlerësuar kapacitetin prodhues dhe jetëgjatësinë e pajisjeve të instaluara në Kuzhinë.

Fund!

Anex 1 Lista e Institucioneve parashkollore

I. Publike

1. IP Yllkat

2. IP Ardhmëria
3. IP Xixëllonjat
4. IP Dielli
5. IP Buzëqeshja
6. IP Fatosat
7. IP Lulevera
8. Gëzimi Ynë

II. Me bazë në komunitet

1. IP Botanika
2. IP Cicërimat
3. IP Këtrushet
4. IP Milingonat
5. IP Ngjyrat
6. IP Shkronjat
7. IP Zogjet
8. IP Shtëpia magjike